



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.08.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1176/23, për zyrtarin e lartë z. Igor Aritonovic, Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Graçanicës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Igor Aritonovic, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Igor Aritonovic, krahas ushtrimit të funksionit publik Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Graçanicës, është edhe përfaqësuese e autorizuar në shoqërinë tregtare "Javno - Komunalno Produzece Ekologija D.D." SH.A.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-02/1231/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, z. Igor Aritonovic është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni".

Zyrtari e lartë z. Igor Aritonovic, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë - konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën nga zyrtarja në fjalë, të cilën më pas e ka konfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/1231-1/2023), se zyrtari e lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme, duke u tërhequr nga përfaqësuesi i autorizuar në shoqërinë tregtare të sipërpërmendur.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtari e lartë z. Igor Aritonovic, ka ndërmarrë masat sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit





U skladu sa članom 5, stav 1, podstav 1.1, stav 1.1.1. članom 12. stav 1. podstav 1.5 i članom 22. stav 3. Zakona br. 08/L-017 o Agenciji za sprečavanje korupcije, članom 31. stav 2. Zakona br. 06/L-011 o Sprečavanju sukoba interesa pri vršenju javne funkcije, kao i članom 7. stav 4. Pravilnika br. 01/2018 o izmenama i dopunama Pravilnika br. 01/2014 i Pravilnika br. 01/2017 o Radu Agencije protiv korupcije, direktor Agencije za sprečavanje korupcije, dana 22.08.2023 godine doneo je:

ODLUKU

Zatvara se slučaj AKK-DRKI-06-1176/23, za visokog zvaničnika g. Igora Aritonovića, direktor Direkcije za upravu u opštini Gračanica, jer je izbegnuta situacija sukoba interesa ili nesaglasnosti sa vršenjem javne funkcije.

Obrazloženje

Slučaj je otvoren pod osnovanom sumnjom o sukobu interesa pri vršenju javne funkcije za visokog zvaničnika g. Igora Aritonovića, i razmatran je prema predviđenim procedurama Zakona br. 06/L-011 o sprečavanju sukoba interesa pri vršenju javne funkcije (dalje: ZSSI).

Razmatranje ovog slučaja počeo je nakon prepoznavanja da g. Igor Aritonović pored vršenja javne funkcije direktora Direkcije za upravu u opštini Gračanica, je i ovlašćeni predstavnik u privrednom društvu "Javno - Komunalno Produzeće Ekologija D.D." A.D.

Agencija za sprečavanje korupcije (dalje: Agencija), je zvaničnim pismom DPKI-06-02/1231/23 obavestila visokog zvaničnika o pokretanju postupka za razmatranje stanja sukoba interesa. Nakon toga, g. Igor Aritonović je obavешten o činjenicama o njegovom slučaju, i upućen je za radnje koje se moraju preduzeti da bi se izbegla situacija sukoba interesa ili nesaglasnosti sa vršenjem javne funkcije.

Visoki zvaničnik tokom vršenja javne funkcije ne može biti ovlašćeni predstavnik u privatnom biznisu, zbog činjenice da takva situacija predstavlja nesaglasnost sa vršenjem javne funkcije, odnosno stanje sukoba interesa. Ovo je zabranjeno odredbom člana 13. stav 1. ZSSI, gde je određeno:

"Visoki zvaničnik ne može da bude menadžer, punomoćnik niti član bilo kog organa upravljanja ili nadzora u privatnom pravnom licu, bilo da je profitno ili neprofitno, izuzev političkih subjekata, subjekata propisanih u članu 14 ovog zakona, kao i u slučajevima kada je takva funkcija zakonom namenjena po osnovu funkcije."



Visoki zvaničnik g. Igor Artonović saglasio se sa nalazima Agencije i izjavio da će odmah preduzeti radnje u cilju izbegavanja situacije nespojivosti – sukoba interesa.

U međuvremenu, Agencija je dobila informaciju od dotičnog zvaničnika, koju je nakon toga potvrdila u ARBK (DPKI-06-02/1231-1/2023) da je visoki zvaničnik izvršio potrebne izmene, povlačeći se od ovlašćenog zastupnika u navedenom privrednom društvu.

Nakon analiziranja gore navedene informacije, Agencija je konstatovala da je visoki zvaničnik g. Igor Artonović preduzeo sve mere, kao što je predviđeno članom 19. stav 1. podstav 1.3. ZSSI-a. Na ovaj način Agencija je zaključila da je radnjama koje je preduzeo visoki zvaničnik izbegnuta situacija sukoba interesa, odnosno nespojivosti sa vršenjem javne funkcije.

Iz iznetog, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka se dostavlja:

- Visokom javnom zvaničniku,
- Direktor DPKI-a,
- G/G-đi. (odgovornom službeniku)

Yil Buleshkaj
Direktor Agencije
za sprečavanje korupcije

